

**Dr. A.S. Tony B. Watlington Sr., Ed.D.**  
Superintendent

Të Nderuara Familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Dita e fundit e shkollës është disa ditë larg dhe vera është pothuajse afër. Ndërsa përfundojmë këtë vit shkollor, i inkurajoj studentët dhe familjet që të përfundojnë fort! Studentët duhet të ndjekin shkollën çdo ditë këtë javë dhe të shkojnë me krenari në verë për të shijuar aktivitete argëtuese dhe kohë të vlefshme me familjen dhe miqtë. Më poshtë janë disa informacione për të na ndihmuar të gjithëve të shijojmë verën në maksimum dhe të na përgatisin për një vit të suksesshëm shkollor 2024-25.

### **Mësimi Veror**

Programimi Akademik Veror fillon më 25 Qershor 2024 për studentët e regjistruar në Drejtorinë. Vendet janë ende të disponueshme në “Young Entrepreneurs Program” për studentët që do të hyjnë në klasën e 9-të. Mësoni më shumë dhe regjistrohuni për “Young Entrepreneurs” [këtu](#). Për më tepër, ka ende vende të disponueshme në disa nga faqet tona “Summer Achievers”, për studentët që do të hyjnë në klasat 1 deri në 8. Ju mund të vizitoni [“Summer Program website”](#) për të mësuar më shumë, ose shkoni direkt te lista e faqeve “Summer Achievers” [këtu](#).

Pavarësisht nëse fëmijët marrin pjesë në programet verore, ne inkurajojmë prindërit dhe familjet që të mbështesin mësimin e vazhdueshëm në shtëpi. Vizitoni bibliotekat lokale për të parë disa nga librat në faqen tonë [“summer reading list”](#). Përveç kësaj, [“this document of Summer Math Recommendations” / ky dokument i Rekomandimeve të Matematikës Verore](#) ofron ide për të ndihmuar nxënësit në çdo nivel klase të zbatojnë aftësitë në numra, forma, të dhëna dhe modele në botën përreth tyre. Qyteti i Filadelfias ofron gjithashtu aktivitete dhe programe falas dhe me kosto të ulët për fëmijët dhe të rinjtë gjatë verës. Vizitoni [www.phila.gov/families](http://www.phila.gov/families) për vendndodhje dhe informacion shtesë.

### **Qëndroni të lidhur në internet**

Drejtoria Arsimore do të punoj shumë këtë verë duke u përgatitur për vitin e ardhshëm shkollor. Kjo do të thotë se ne do të ndajmë me ju lajme dhe përditësime gjatë gjithë verës, veçanërisht kur jemi më afër ditës së parë të shkollës. Një lidhje e besueshme në internet do të jetë e rëndësishme për të qëndruar të përditësuar. Megjithatë Programi i Lidhshmërisë së Përballueshme (ACP) të qytetit të Filadelfias ka skaduar, qyteti po mbështet familjet në marrjen e internetit falas ose me kosto të ulët përmes PHLConnectED. Nëse keni vënë re se shërbimi juaj ka përfunduar, ose fatura juaj është rritur, ose nëse thjesht kërkon një mundësi interneti me kosto të ulët, ju lutemi vizitoni [faqen e internetit ne: PHLConnectED](#) ose telefononi 2-1-1 për të folur me një Navigator Dixhital të Qytetit të Filadelfisë.

### **Imunizimet & Kontrollat Fizike**

Drejtoria ka partneritet me Delaware Valley Community Health, Black Doctors Consorciun dhe Rrjetin e Praktikës dhe Këshillimit Familjar, për të ofruar vaksina dhe kontrolle fizike sportive për studentët e drejtorisë në vende të caktuara gjatë muajit Korrik dhe Gusht. Shërbimet fizike dhe të imunizimit ofrohen për të gjithë studentët pavarësisht statusit të sigurimit. Gjeni datat dhe vendndodhjet e vaksinimit të verës dhe ngjarjeve fizike, shikoni moshën dhe kërkesat e dokumenteve për ngjarje specifike dhe rezervoni një takim në [www.philasd.org/vax](http://www.philasd.org/vax).

Studentët mund të marrin gjithashtu ekzaminime dentare falas gjatë gjithë verës në Klinikën Dentare të Fëmijëve në Shkollën W.D. Kelley, që ndodhet në 1601 N 28th St., Philadelphia, PA 19121. Klinika dentare ofron ekzaminime, mbushje, kurora, heqje dhe kujdes urgjent. Zbuloni se si të rezervoni një takim duke vizituar “[Student Health website.](#)” /[Faqja e Internetit e Shëndetit të Studentëve.](#)

Në të vërtetë, ka shumë për të bërë këtë verë në përgatitje të ditës së **Hënë, 26 Gusht** – dita e parë e shkollës. Ju lutemi, kujdesuni për më shumë informacione këtë verë, duke përfshirë informacionin për Turneun tonë të 4-të Vjetor me Autobus Përsëri në Shkollë, në mënyrë që të jeni të përgatitur mirë për t'u kthyer në vjeshtë. Deri atëherë, kalofshi një verë të mrekullueshme!

Në partneritet,



Tony B. Watlington Sr., Ed.D.  
Superintendent  
Drejtoria Arsimore e Filadelfias